Programi AB141: Siguria Publike dhe Mbrojtja civile

Permbajtja

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit AB141 2
1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike 5
2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit 7
3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit 9
4. Projektet e Investimeve të Programit 12
5. Të Dhëna mbi Programin 13
6. Projektet e planifikuara për PBA 2027-2029 15

HYRJE

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit AB141

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë, mbarëvajtjes së punëve publike, aktiviteteve sportive, kulturore, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Masa të njësisë së vetëqeverisjes vendore për të rritur besimin e qytetarëve dhe marrëdhënien e njësisë me komunitetin. Për qëllime bashkëpunimi njësia vendore planifikon aktivitete të cilat ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve sa më afër kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse. Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
AB141	Siguria Publike dhe Mbrojtja civile	• Sigurimi i mbrojtjes, rendit e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; • Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë. • Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj.

- Ruajtjen e rendit, të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike brenda tërritorit të Bashkisë.
- Sigurimi i mbrojtjes, rendit e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda tërritorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjeter shtetëror.

- Ekzekutimin dhe zbatimin e akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë.
- Zbatimin e detyrimeve dhe përgjegjësive që ngarkojnë dhe autorizojnë Policinë Bashkiake për të vepruar, në respektim të ligjit 89/2022 "Për Policinë Bashkiake".
- Mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, kontrollin e hapësirave publike, qarkullimit rrugor, fushës ekonomike, zonave turistike etj..
- Ngritjen dhe zgjerimin e struktures së vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme e strukturave të mbrojtjes civilë në partneritet me organizata e shoqërisë civile.
- Zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë përmes aktivizimit të shërbimit të mbrojtjes civile.
- Përmirësimin e sigurisë publike në të gjithë tërritorin e Bashkisë Shkodër, duke siguruar informacion publik të vazhdueshëm për rreziqet, aktivitetet e shërbimet Bashkisë, me prioritet parandalimin e situatave që cënojnë sigurinë e jetës dhe pronës së qytetarëve, bizneseve, aseteve administrative, pasurive kulturore, natyrore, etj.
- Vlerësimin e dëmeve nga specialistët e ngarkuar me urdhër të brendshëm dhe përllogaritjet financiarë të vlerësimit për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.
- Hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit për dhënien e ndihmës së menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie.
- Kryerjen e kontrollit sistematik vjetor dhe certifikimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin të objekteve të Bashkisë sipas prioriteteve.
- Blerjen e fikseve automatike të zjarrit, rimbushjen e bombolave të fikseve automatike të zjarrit për objektet institucione publike në administrim të Bashkisë Shkodër.
- Rimbushjen e bombulave e fikseve automatike të zjarrit në shkolla, bombulave të fikseve automatike të zjarrit për rimbushje gjendje pranë MZSH-se, dhe në godinën e Bashkisë Shkodër për përdorim në rast emergjence.
- Trajtimin dhe vlerësimin e akteve tëknike për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin për objektet.
- Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për popullsinë: Shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Kjo strukturë ka kryer inspektimin, parandalimin, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrje për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave, ndërhyrje në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Sfida:
Nevojë për më shumë bashkërendim ndërmjet institucioneve, me Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit, AKU, etj. Implementim i strategjisë për Policimin në Komunitet.

- Përzgjedhja e punonjësve për Policinë Bashkiake në mënyrë sa më cilësore nëpërmjet organizimit të konkurimeve me standarte më të larta, por edhe duke ofruar barazi, ndershmëri dhe dinjitet.
- Kontrolli e monitorimi i parkimeve dhe qarkullimit rrugor në qytetin e Shkodrës, rregullimi i problematikave në këtë drejtim.
- Lirimi i trotuareve dhe hapësirave të tjera publike që zaptohen nga bizneset, ambulantët. Në këto raste duhet të veprohet me forcë për lirimin e hapësirave publike (trotuare). Trotuaret bllokohen nga ambulantët/bizneset/njësitë tregtare

ndërsa qytetarët detyrohen të ecin në rrugë. Duhet të shihet me përparësi lirimi i hapësirave publike në tërësi dhe jo vetëm trotuare.

- Mungesa e mjeteve të mjaftueshme për përballimin e situatave që krijohen nga emergjencat civile.

1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

Raporti:PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi:AB141 - Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile
PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2024	FAKTI 2025	FILLESTAR 2026	RISHIKUAR 2026	PLANI 2027	PLANI 2028	PLANI 2029
	Shpenzime Personeli (600-601)	**83,310**	**115,334**	**156,637**	**174,237**	**174,479**	**174,479**	**174,478**
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	71,389	99,350	135,146	150,254	150,536	150,536	150,536
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	11,921	15,983	21,491	23,983	23,943	23,943	23,942
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	**14,538**	**13,365**	**61,583**	**121,071**	**54,063**	**53,895**	**54,571**
602	Mallra dhe sherbime te tjera	13,021	11,336	26,880	102,797	18,172	18,133	18,133
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	32,363	13,567	33,551	33,422	34,098
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	1,518	2,029	2,340	4,707	2,340	2,340	2,340
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	**1,973**	**3,238**	**26,234**	**44,469**	**2,303**	**1,000**	**1,000**
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	1,000	3,000	1,000	1,000	1,000
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	1,973	3,238	25,234	41,469	1,303	0	0
	Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	**0**	**0**	**2,514**	**3,143**	**2,514**	**629**	**0**
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	0	2,154	2,693	2,154	539	0
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	0	360	450	360	90	0
	Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	**0**	**0**	**162**	**324**	**374**	**0**	**0**
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0	162	324	374	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	**0**	**0**	**0**	**0**	**2,332**	**0**	**0**
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	0	0	0	2,332	0	0
	TOTALI	**99,822**	**131,936**	**247,130**	**343,244**	**236,065**	**230,002**	**230,049**

Komente
Programi P.AB141: Siguria Publike dhe Mbrojtja civile, ka si burim financimi transfertën specifike, transferten e pakushtëzuar dhe të ardhurat e bashkisë. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me: • 75.0 % në vitin 2027, • 76.1 % në vitin 2028, • 75.8 % në vitin 2029. Shpenzimet korrente zënë: • 23.1 % per vitin 2027, • 23.4 % per vitin 2028, • 23.7% per vitin 2029. Shpenzimet kapitale zënë : • 2.0% per vitim 2027, • 0.4% per vitin 2028, • 0.4 % per vitin 2029.

2.Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Raporti: PBA6 - Deklarata së Politikës së Programit
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi: AB141 - Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile PBA: 2027 - 2029

Përshkrimi i Politikës së Programit
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike ;Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

1	**Qëllimi i Politikës së Programit**	Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkise dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.			
	TP për Qëllimin:	2026		2030	
	Numër punonjësish të trajnuar, kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake *(%)*	95		95	
	Rritja e rasteve të menaxhuara nga policia Numri i akteve të ekzekutuara kundrejt akteve të nxjerra *(%)*	90		90	
1.1	**Objektivi i Politikës së Programit**	Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për rritjen e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.			
	TP për Objektivin:	2026	2027	2028	2029
	Raporti midis punonjësve me status kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake *(%)*	5	5	5	5
	Numër punonjësish të trajnuar, kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake *(%)*	95	95	95	95
	Shpenzimet buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara *(mije leke/1 rast)*	41	52	52	52
	Numri i rasteve problematikave të menaxhuara kundrejt rasteve të raportuara/konstatuara *(%)*	93	154	154	154
	Rritja e rasteve të menaxhuara nga policia Numri i akteve të ekzekutuara kundrejt akteve të nxjerra *(%)*	90	90	93	90
	Numer kamera te vendosura ne pika strategjike te qytetit *(numër)*	125	125	125	125
2	**Qëllimi i Politikës së Programit**	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile. 1.Perafrimi me standartet europiane te organizimit te mbrojtjes civile. 2.Sigurimi i mbrojtjes civile ne te gjithe territorin. 3. Parandalimi.4.Informim publik per rreziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.			
	TP për Qëllimin:	2026		2030	
	Numri i familjeve përfituese të dëmshpërblyera nga fatkeqësi natyrore *(numër)*	280		250	
	Numri i familjeve të trajtuara për fatkeqësi nga zjarri *(numër)*	30		30	
	Numri i stacioneve të shërbimit te MZSH-së *(numër)*	2		2	
	Numri i punonjësve të MZSH / banor (1 punonjës për 1500 – 2000 banor) *(punonjes/ 1500 banore)*	0.52		0.52	
	Zona e mbuluar nga shërbimi i MZSH në % *(%)*	29		29	
	Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre *(sekonda)*	45		45	
2.1	**Objektivi i Politikës së Programit**	Strukturat per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.			

	TP për Objektivin:	2026	2027	2028	2029
	Numri i familjeve përfituese të dëmshpërblyera nga fatkeqësi natyrore *(numër)*	280	280	280	250
	Numri i punonjësve të sektorit të emergjencave civile *(numër)*	8	8	8	8
	Numri i familjeve të trajtuara për fatkeqësi nga zjarri *(numër)*	30	30	30	30
	Numri i kontrolleve sistematike vjetore për certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë. *(numër)*	185	185	185	185
	Numrit të ofruar të pajisjeve dhe kolaudimi i fikësve të zjarrit në institucione *(numër)*	1517	1517	1517	1517
	Numri i sistemeve të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë që përdorin *(numër)*	1	1	1	1
2.2	**Objektivi i Politikës së Programit**	Shërbim I përmirësuar I MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.			
	TP për Objektivin:	2026	2027	2028	2029
	Numri i projekteve teknike për masat e MZSH në institucione *(numer)*	110	140	140	140
	Numri i stacioneve të shërbimit të MZSH-së *(stacion)*	2	2	2	2
	Numri i punonjësve të MZSH / banor *(punonjes/ 1500 banore)*	0.52	0.52	0.52	0.52
	Zona e mbuluar nga shërbimi i MZSH *(%)*	29	29	29	29
	Rritja e të ardhurave nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve *(leke)*	2300	2600	2700	2700
	Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre *(sekond)*	45	45	45	45
	Mbulimi kostove të shërbimit MZSH nga të ardhurat e shërbimit *(%)*	2.6	3.2	3.3	3.3
	Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH *(lekë/rast të menaxhuar)*	143	125.5	125.5	125.5

3.Plani i shpenzimeve te produkteve te programit.

Raporti : PBA 7-Shpenzimet e Produkteve te Programit
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi: AB141 - Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile
PBA:2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

Objektivi i Politikës së Programit	Ob 1.1 - Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për rritjen e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.			
Produkti	V314AAB - Patrullim për Sigurinë Publike			
Përshkrimi i Produktit	Ky produkt përfshin të gjitha aktivitetet e Policisë Bashkiake në lidhje me inspektimet per parandalimin e kundravajtjeve administrative (shpenzime karburant, automjete, uniforma nje here ne dy vjet); Kostot e personelit të policisë bashkiake (paga dhe sigurime), etj.			
Njësia e Matjes	numer rastesh			
	2026 Buxheti	**2027 Plani**	**2028 Plani**	**2029 Plani**
Sasia	2,800	1,850	1,850	1,850
Shpenzime Totale	114,110	95,890	95,851	95,851
Shpenzime Totale për Njësi	40.753	51.832	51.811	51.811
Ndryshimi në % i Sasisë		-34.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-16.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		27.00%	0.00%	0.00%
Objektivi i Politikës së Programit	Ob 2.1 - Strukturat per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.			
Produkti	V328AAB - Shërbime të Mbrojtjes Civile			
Përshkrimi i Produktit	Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile.			
Njësia e Matjes	nr punonjesish			
	2026 Buxheti	**2027 Plani**	**2028 Plani**	**2029 Plani**
Sasia	8	8	8	8
Shpenzime Totale	14,243	12,701	12,701	12,701
Shpenzime Totale për Njësi	1,780.319	1,587.625	1,587.625	1,587.625
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-11.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		-11.00%	0.00%	0.00%
Produkti	V091AAD - Familje të Dëmshpërblyera për Dëme nga Zjarri			
Përshkrimi i Produktit	Shpenzimet nga buxheti i njësve të vetëqeverisjes vendore për shpërblimin e familjve të dëmtuara nga zjarri sipas legjislacionit për mbrojtjen civile			
Njësia e Matjes	nr familjesh			
	2026 Buxheti	**2027 Plani**	**2028 Plani**	**2029 Plani**
Sasia	30	30	30	30
Shpenzime Totale	4,260	2,340	2,340	2,340
Shpenzime Totale për Njësi	142.000	78.000	78.000	78.000
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-45.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		-45.00%	0.00%	0.00%

Produkti	V091AAB - Ndërhyrje Parandaluese dhe Emergjente			
Përshkrimi i Produktit	Aktivitetet dhe shpenizmet e parashikuara ne buxhetin e njesive te veteqeverisjes vendose per kryerjen e punimeve te karakterit parandalues dhe emergjent te lidhura me emergjencat civile.			
Njësia e Matjes	Nr familjesh			
	2026 Buxheti	**2027 Plani**	**2028 Plani**	**2029 Plani**
Sasia	280	280	280	250
Shpenzime Totale	93,667	35,051	34,922	35,598
Shpenzime Totale për Njësi	334.525	125.182	124.721	142.392
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	-11.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-63.00%	0.00%	2.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		-63.00%	0.00%	14.00%
Objektivi i Politikës së Programit	Ob 2.2 - Shërbim I përmirësuar I MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.			
Produkti	V328AAC - Raste të Menaxhuara të Zjarrit dhe Shpëtimit			
Përshkrimi i Produktit	Ky produkt ka të bëjë me krijimin e gadishmërisë së duhur njerëzore, mjete dhe materiale për t'ju përgjigjur në kohë rasteve të zjarrit dhe shpëtimit në objekte banimi, pyje dhe kullota, aksidente në rrugë, etj. Këtu do të përfshihen njëkohësisht edhe aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me marrjen e masave parandaluese të zjarrit apo aksidenteve, përfshirë mjete apo materiale të nevojshme si dhe fushata të ndryshme sensibilizuese.			
Njësia e Matjes	nr rastesh			
	2026 Buxheti	**2027 Plani**	**2028 Plani**	**2029 Plani**
Sasia	620	650	650	650
Shpenzime Totale	100,116	83,560	83,560	83,559
Shpenzime Totale për Njësi	161.478	128.553	128.553	128.553
Ndryshimi në % i Sasisë		5.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-17.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		-20.00%	0.00%	0.00%

4. Projektet e Investimeve të Programit

Raporti: PBA8 - Projektet e Investimeve NJVQV:
141 - Bashkia Shkodër
PBA: 2027 - 2029
Programi: AB141 - Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	BURIMI I FINANCIMIT	DATA E FILLIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	KOSTO TOTALE	2024 FAKTI	2025 FAKTI	2026 BUXHETI	2027 PLANI	2028 PLANI	2029 PLANI
Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve											
P091AAH	Projekti Territory	Financim i Huaj	01/11/2025	31/12/2028	11,586	0	0	967	3,635	0	0
P091AAG	Reduktimi i pasojave të përmbytjes	Financim i Brendshëm	01/01/2026	31/12/2026	12,414	0	0	12,414	0	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve					24,000	0	0	13,382	3,635	0	0
Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve											
V314AAB	Patrullim për Sigurinë Publike					0	0	16,282	0	0	0
V328AAC	Raste të Menaxhuara të Zjarrit dhe Shpëtimit					0	0	7,005	1,000	1,000	1,000
V091AAB	Ndërhyrje Parandaluese dhe Emergjente					0	0	7,800	0	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve						0	0	31,087	1,000	1,000	1,000
Totali i Përgjithshëm						0	0	44,469	4,635	1,000	1,000

5. Të Dhëna mbi Programin

Raporti: PBA9 - Informacion mbi Programin
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi: AB141 - Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile
PBA: 2027 – 2029

		FUNKSIONI	TË PËRGJITHSHME	2022	2023	2024	2025	2026
1	**PUNONJËS ME STATUS TË OFICERIT TË POLICISË BASHKIAKE**	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	3.00	3.00	2.00	3.00	3.00
2	**SHPENZIMET BUXHETORE PËR SHËRBIMET E POLICISË BASHKIAKE MIJË LEKË**	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	26,213.00	25,166.00	35,234.00	51,649.00	114,110.00
3	**RASTE TË MENAXHUARA NGA POLICIA BASHKIAKE:**	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	265.00	515.00	745.00	3,359.00	2,800.00
3.1	Mbështetja e strukturave të IMT dhe sherbime te tjera (nr rastesh)	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	40.00	120.00	190.00	510.00	350.00
3.2	Ruajtja e qetësisë publike / lokale/aktivitete masive / etj. (nr rastesh)	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	200.00	325.00	450.00	400.00	450.00
3.3	Menaxhimi i konflikteve	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	25.00	70.00	105.00	2,449.00	2,000.00
4	**NUMRI I RASTEVE TË RAPORTUARA NGA POPULLATA, ETJ TEK POLICIA BASHKIAKE**	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	230.00	310.00	316.00	2,588.00	3,000.00
5	**NUMRI I AKTEVE ADMINISTRATIVE TË NXJERRA NGA POLICIA BASHKIAKE**	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	1,050.00	2,796.00	30,955.00	39,132.00	50,000.00
6	**NUMRI I AKTEVE ADMINISTRATIVE TË EKZEKUTUARA**	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	250.00	1,006.00	27,685.00	35,194.00	45,000.00
7	**NUMRI I KAMERAVE TË VENDOSURA NË PIKA STRATEGJIKE TË QYTETIT**	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	0.00	41.00	81.00	81.00	107.00	125.00
8	**NUMRI I FAMILJEVE PËRFITUESE QË PËRFITOJNË NGA FATKEQËSITE NATYRORE**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	37.00	200.00	141.00	124.00	280.00
8.1	Numri i familjeve përfituese që përfitojnë për rastet e zjarrit	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	37.00	23.00	40.00	24.00	30.00

8.2	Numri i familjeve përfituese që përfitojne nga përmbytjet/rrëshqitje dhera	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	0.00	177.00	101.00	100.00	250.00
9	**NUMRI I KONTROLLEVE SISTEMATIKE VJETORE PËR CERTIFIKIMIN PËR MZSH I OBJEKTEVE TË BASHKISË.**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	130.00	120.00	180.00	0.00	185.00
10	**POPULLSIA NË ZONËN E SHËRBIMIT**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	210,182.00	213,217.00	210,182.00	210,182.00	210,182.00
11	**SIPERFAQJA E TERRITORIT E MBULUAR ME SHËRBIM MZSH NE KM2**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	253.00	253.00	253.00	253.00	253.00
12	**SIPERFAQJA TOTALE E BASHKISË SHKODËR KM 2**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	873.00	873.00	873.00	873.00	873.00
13	**TË ARDHURAT NGA TARIFAT PËR SHËRBIMIN NDAJ TË TRETËVE (PAJISJA ME ÇERTIFIKATA, ETJ) NË MIJË LEKË**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	1,357.00	2,079.00	2,570.00	1,457.00	2,300.00
14	**NUMRI TOTAL I RASTEVE TË MENAXHUARA**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	534.00	458.00	645.00	648.00	650.00
15	**KOHA E DALJES NGA STACIONI NË SEKONDA**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	45.00	45.00	45.00	45.00	45.00
16	**BUXHETI TOTAL I MZSH NË MIJË LEKË**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	44,577.00	48,709.00	57,171.00	67,240.00	96,111.00
17	**NUMRI I PAJISJEVE FIKJE ZJARRI FUNKSIONALE**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	1,517.00	1,517.00	1,517.00	1,517.00	1,517.00
18	**NUMRI I PROJEKTEVE TEKNIKE PËR MASAT E MZSH**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	54.00	73.00	99.00	110.00	110.00
19	**NUMRI I STACIONEVE TE MZSH**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	1.00	1.00	1.00	1.00	2.00
20	**KOHA E DALJES NGA STACIONI NE SEKONDA : NATEN**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	7.00	7.00	7.00	7.00	7.00
21	**KOHA E DALJES NGA STACIONI NE SEKONDA**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	60.00	60.00	60.00	60.00	60.00
22	**NUMRI I SISTEMEVE TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË QË PËRDORIN TEKNOLOGJI INOVATIVE OSE IA.**	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0.00	0.00	0.00	0.00	1.00	1.00

6. Projektet e planifikuara për PBA 2027-2029

Produktet	Aktivitete/Projekte	Institucioni	Buxheti 2027	Buxheti 2028	Buxheti 2029
			Totali	Totali	Totali
V314AAB. Patrullim për Sigurinë Publike (Nr.rasteve të menaxhuara nga policia bashkiake)	P.AB141.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv te Policise Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	Bashkia Shkodër	87,390	87,390	87,390
	P.AB141.Q1.O1.A2 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	Bashkia Shkodër	1,000	1,000	1,000
	P.AB141.Q1.O1.A3 Telekomunikim për policinë bashkiake	Bashkia Shkodër	100	100	100
	P.AB141.Q1.O1.A4 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policise Bashkiake	Bashkia Shkodër	3,900	3,861	3,861
	P.AB141.Q1.O1.A5 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policise bashkiake	Bashkia Shkodër	1,500	1,500	1,500
	P.AB141.Q1.O1.A6.Kamera sigurie(CCTV) per ambjente publike dhe mirembajtja e tyre.	Bashkia Shkodër	2,000	2,000	2,000
03140 Sherbimet e policisë vendore			**95,890**	**95,851**	**95,851**
V091AAB. Ndërhyrje Parandaluese dhe Emergjente (numer rastesh)	P.AB141.Q2.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. Burimet e veta	Bashkia Shkodër	33,551	33,422	34,098
	P.AB141.Q2.O1.A2.Mjete funksionale per operacione, mbikeqyrje, monitorim dhe parandalim te emergjencave civile.	Bashkia Shkodër	-	-	-
	P.AB141.Q2.O1.A3.Paisje dhe veshje per emergjencat civile.	Bashkia Shkodër	500	500	500
	P.AB141.Q2.O1.A4.Furnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile.	Bashkia Shkodër	1,000	1,000	1,000
V328AAB - Shërbime të Mbrojtjes Civile (numer punonjes)	P.AB141.Q2.O1.A6.Paga per sektorin e emergjencave te Bashkise.	Bashkia Shkodër	12,701	12,701	12,701

V091AAD. Familje të Dëmshpërblyera për Dëme nga Zjarri (numri i familjeve)	P.AB141.Q2.O1.A5.Perballimi I ndihmave menjehershme per familjet ne raste fatkeqsie.	Bashkia Shkodër	2,340	2,340	2,340
P091AAH Projekti "Territory"(nr.i sitemeve)	P.AB141.Q2.O1.A7.Projekti Territory	Bashkia Shkodër	6,523	629	-
V328AAC. Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit (në numër)	P.AB141.Q2.O2.A8.Plotesimi dhe certifikimi per MZSH i paisjeve per fikje zjarri I te gjithe Institucioneve te Bashkise	Bashkia Shkodër	1,000	1,000	1,000
	P.AB141.Q2.O2.A1. Plotesimi I dokumentacionit ligjor teknik per masat MZSH I te gjitha objekteve te varesi te Bashkise.	Bashkia Shkodër	1,000	1,000	1,000
	P.AB141.Q2.O2.A2. Sherbimi I Mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi	Drejtoria e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	81,560	81,560	81,560
03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile			**140,175**	**134,152**	**134,199**
P.AB141 Siguria Publike dhe Mbrojtja civile			**236,065**	**230,003**	**230,050**
Totali			**236,065**	**230,003**	**230,050**

Nr. 1	**P.AB141.Q1.O1.A1.** Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	**Programi AB141**: Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

- **Paga dhe shtesat mbi paga**

Policia bashkiake ushtron aktivitetin e saj bazuar në ligjin nr. 89/2022, "*Për Policinë Bashkiake*, Vendimit të Këshillit Të Ministrave nr.452, datë 26.07.2023 "Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake".

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 19.12.2025, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", si dhe të VKM nr. 103, datë 11.02.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, si dhe në ndryshim të VKB nr. 54, datë 30.09.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë", dhe VKB nr. 13, datë 27.02.2026, llogaritet buxheti për shpenzimet e personelit, i cili bazohet në numrin e punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave përkatëse dhe shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe brenda kufijve minimalë dhe maksimalë të miratuar

Struktura e policisë bashkiake përfshin 58 punonjës të Policisë Bashkiake. Punonjësit e policisë kanë realizuar trajnime përkatëse konform dispozitave ligjore, të ofruara nga Akademia e Sigurisë Tiranë.

- **Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore**

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

- **Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim**

Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24. 12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit

ii. Synimi i projektit

Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të Policisë Bashkiake

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për Policinë Bashkiake.

b) Rezultatet që prisni

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të Policisë Bashkiake nëmbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

c)Aktorët e mundshëm	**d)Kontributet e mundshme në projekt**
1. Policia Bashkiake 2. Drejtoria e Financës 3. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër	Bashkia e Shkodrës

e)Shpenzime të llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali(mijë lekë)					
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	75,398	75,398				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	11,992		11,992			
	Shuma 2027	**87,390**	75,398	11,992			

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali(mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative		Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	75,398	75,398				
A.2	Kontributi për shëndetësore sigurime dhe shoqërore	11,992		11,992			
	Shuma 2028	**87,390**	75,398	11,992			

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali(mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative		Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	75,398	75,398				
A.2	Kontributi për shëndetësore sigurime dhe shoqërore	11,992		11,992			
	Shuma 2029	**87,390**	75,398	11,992			

f)Periudha e zbatimit 2027-2029	**g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Policia Bashkiake **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr.2	**P.AB141.Q1.O1.A2.** Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	**Programi AB141**: Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrim i shkurtër i projektit

i. Situata

Bazuar në ligjin nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake",vendimin e Këshillit të Ministrave nr.494/2023 për "Miratimin e uniformave të Policise Bashkiake", dhe urdhërat në zbatim të këtij ligji ku përcaktohen qartë standartet dhe kriteret për normat e uniformave të policisë bashkiake është e nevojshme që të realizohet blerja e kompleteve verore, dimërore ose të ceremonialit dhe sportive(të çiklistave) për punonjësit të Policisë Bashkiake në vijim sipas normave ose për punonjësit e rinj.

ii. Synimi i projektit

Rritja e imazhit para komunitetit për një prezantim sa më dinjitoz, përmirësimi i performancës së Policisë së Bashkisë dhe zbatimit të ligjit në shërbim të qytetarëve.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Identifikimi i kërkesave për uniforma
2. Përgatitja e dokumentacionit për prokurim në zbatim të ligjit
3. Zbatimi procesit (blerja e uniformave)

b) Rezultatet e pritshme

Përmirësim i imazhit të Policisë së Bashkisë, përmirësimi i kushteve të punës.

c) Aktoret e mundshem	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
1. Policia Bashkiake 2. Institucioni që ndjek shpenzimet:Bashkia Qendër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Blerje uniforma	**1,000**		1,000	
Shuma 2027		**1,000**		**1,000**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Blerje uniforma	**1,000**		1,000	
Shuma 2028		**1,000**		**1,000**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali(mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Blerje uniforma	**1,000**		1,000	
Shuma 2029		**1,000**		**1,000**	

f)Periudha e zbatimit 2027-2029	**g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Policia Bashkiake **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr.3	**P.AB141.Q1.O1.A3** Telekomunikim për Policinë Bashkiake	**Programi AB141**: Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrim i shkurtër i projektit

i. Situata

Bazuar në ligjin nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake",vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452/2023, keu II, neni 3 "Paisjet e Policise Bashkiake" percaktohet nder paisjet per kryerjen e detyrave, punonjesi i Policise Bashkiake duhet te jete i paisur me radio marrese dhënëse, telefon. Aktualisht sistemi i radiove marrëse - dhënëse ka mangësi të theksuara. Konkretisht me sistem kuptojmë përsëritësin e sinjalit(përforcuesin), aksesorët dhe antenën, një radio bazë, antenë dhe aksesorë të saj. Përsëritësi vendoset në një vend të lartë mundëson përforcimin e komunikimit mes radiove marrëse dhënëse të punonjësve për të mbuluar territorin ku operohet.
Aktualisht Policia Bashkiake disponon numer kontakti per t'ju pergjigjur qytetarëve,subjekteve për ankimet apo raportimet e ndryshme.

ii. Synimi i projektit

Krijimi i ndërlidhjes mes të gjithë hallkave të policisë bashkiake gjatë shërbimit rrit performacën, eviton vonesat në kohën e reagimit, rrit sigurinë personale të punonjësve.
Nr. Telefonit të kontaktitin krijon aksesin tek poilicia bashkiake për qytetarët,subjektet në kohë reale, efektet e tjera shton besimin e komunitetit tek Policia Bashkiake.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Identifikimi i nevojave per krijimin e sistemit ,
2. Përgatitja e dokumentacionit për prokurim në zbatim të ligjit
3. Zbatimi procesit

b) Rezultatet e pritshme

Rritje e efektivitetit të punës dhe e sigurisë të punonjesve të Policisë së Bashkisë.

c) Aktoret e mundshem	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
1. Policia Bashkiake 2. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sigurime	Operative	Kapitale
A1	Mirëmbajtje të sistem përsëritës, përforcues të sinjalit të radiove të dorës për policinë bashkiake (repititor, radio bazë, aksesor të ndryshëm në valën UHF/VHF)	**80**		80	
A.2	Shërbim telefonik per nevojat e drejtorise	**20**		20	
Shuma 2027		**100**		**100**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje të sistem përsëritës, përforcues të sinjalit të radiove të dorës për policinë bashkiake (repititor, radio bazë, aksesor të ndryshëm në valën UHF/VHF)	**80**		80	
A.2	Sherbim telefonik per nevojat e drejtorise	**20**		20	
Shuma 2028		**100**		**100**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje të sistem përsëritës, përforcues të sinjalit të radiove të dorës për policinë bashkiake (repititor, radio bazë, aksesor të ndryshëm në valën UHF/VHF)	**80**		80	
A.2	Shërbim telefonik për nevojat e drejtorisë së Policisë Bashkiake	**20**		20	
Shuma 2029		**100**		**100**	

f)Periudha e zbatimit	**g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
2027-2029	Policia Bashkiake**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr. 4	**P.AB141.Q1.O1.A4** Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake	**Programi AB141**: Siguria publike dhe Mbrojtja civile

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Në funksion të Policisë Bashkiake janë 8 automjete nga të cilat:1 automjet Land Rover dhe 1 automjet karrotrec ,3 janë të dhuruara, të amortizuara, 3 janë të reja automjete elektrike. Automjetet kanë nevojë në vazhdimësi për shërbime mirëmbajtje, furnizim me karburant, shërbimin e kontrollit teknik, pagesën e taksave dhe siguracioneve gjatë vitit, larje e pastrim. Per shkak te rritjes se ngarkeses ne pune, ne drejtim te qarkullimit rrugor, te kontrollit te territorit, shtimit te punës në pikat turistike ka lindur domosdoshmëria e shtimit dhe mbajtjes në efiçencë të automjeteve për trupat e shërbimit si dhe marrjen e automjeteve të reja elektrike realizohet në vitin 2026.

ii. Synimi i projektit

Mjete transporti funksionale, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të Policisë Bashkiake sipas nevojave që ato kanë.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Vlerësimi i gjendjes teknike të mjeteve të transportit në serviset e liçensuara dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të riparohen dhe të kthehen apo të mbahen në gjendje pune, si dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të nxirren jashtë përdorimit nga komisioni (proces në vazhdim).
2. Identifikimi i nevojave për karburant, pjesë këmbimi dhe shërbimi i mirëmbajtjes së këtyre automjeteve.
3. Përgatitja e preventivave dhe dokumentacio neve përkatëse të nevojshme për prokurim.
4. Zbatimi i procedurave të prokurimit sipas specifikimeve teknike të paracaktuara dhe monitorimi.

4.1. Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër
4.2. Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit
4.3. Siguracioni i automjeteve
4.4. Taksa qarkullimi, kolaudimi

5. Marrja në dorëzim dhe magazinimi i mallrave apo shërbimeve

b) Rezultatet e pritshme

Mjete transporti në gjendje pune në gadishmëri më të lartë për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme tëpolicisë vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme**
Policia Bashkiake Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastrukturës Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo :		
			Paga,sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër	**1,500**		1,500	
A. 2	Shërbim mirëmbajtje për mjetet e transportit, sherbime te tjera (larje automjetit, GBS)	**1,500**		1,500	
A. 3	Siguracioni i automjeteve	**500**		500	
A. 4	Pagesa e taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**400**		400	
Shuma 2027		**3,900**		**3,900**	

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo :		
			Paga,sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër	**1,500**		1,500	
A. 2	Shërbim mirëmbajtje për mjeteve të transportit,sherbime te tjera(larje automjetit,GBS)	**1,461**		1,461	
A. 3	Siguracioni i automjeteve	**500**		500	
A. 4	Pagesa e taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**400**		400	
Shuma 2028		**3,861**		**3,861**	

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Blerje karburanti për nevojat e Policisë Bashkiake Shkodër	**1,500**		1,500	

A. 2	Shërbim mirëmbajtje për mjeteve të transportit,sherbime te tjera(larje automjetit)	**1,461**		1,461	
A. 3	Siguracioni i automjeteve	**500**		500	
A. 4	Pagesa e taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**400**		400	
Shuma 2029		**3,861**		**3,861**	

f)Periudha e zbatimit 2027-2029	**g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Policia Bashkiake **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr.5	**P.AB141.Q1.O1.A5** Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake	**Programi AB141**: Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrim i shkurtër i projektit

i. Situata

Sasia e shtypshkrimeve duhet të plotësohet çdo vit sipas nevojave të Policisë Bashkiake. Mungesa në materiale sjell pasoja në përmbushjen e detyrave dhe kërkon vazhdimisht planifikim shpenzimi për blerjet e dokumentacioneve të domosdoshme e për kryerjen dhe ofrimin e shërbimeve. Rritja e kërkesës për blerje të dokumentacionit (shtypshkrime të ndryshme, akt konstatimi, blloqe gjoba, liber shërbime etj) është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës së Policisë Bashkiake në Bashkinë Shkodër dhe kërkohet sigurimi I dokumentacionit për: blloqe gjoba dhe blloqe akt konstatimi, blloqe për akte të tjera
administrative në rastet e automjeteve që do të zhvendosen, libra sherbimit etj..

ii. Synimi i projektit

Të rritet performanca në punë e Policisë Bashkiake të Bashkisë. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me shtypshkrime, që t'iu mundësojë punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Identifikimi i kërkesës për materiale
2. Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet
3. Zbatimi procedurave tenderuese

3.1 Blerje dokumentacione (shtypshkrime)

3.2 Marrja në dorëzim dhe magazinimi i materialeve

4. Shpërndarja sipas planit të aktiviteteve të projektit
5. Sigurimi dhe furnizimi sipas kërkesave

b) Rezultatet e pritshme

- Përmirësim i kushteve të punës dhe përmbushja e detyrave në kohë për policine bashkiake të Bashkisë Shkodër
- Rritja e eficensës dhe efektivitetit në punë nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë siç është furnizim i vazhdueshëm me shtypshkrime për punonjësit.
- Rritjen e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së punës në shërbim të komunitetit.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër	Bashkia e Shkodrës

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	Operative	Kapitale
A.1	Blerje dokumentacione (shtypshkrime)	**1,500**		1,500	
Shuma 2027		**1,500**		**1,500**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	Operative	Kapitale
A.1	Blerje dokumentacione (shtypshkrime)	**1,500**		1,500	
Shuma 2028		**1,500**		**1,500**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	Operative	Kapitale
A.1	Blerje dokumentacione (shtypshkrime)	**1,500**		1,500	
Shuma 2029		**1,500**		**1,500**	

f) Periudha e zbatimit	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Policia Bashkiake **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër
2027-2029	

Nr.6	**P.AB141.Q1.O1.A6** Kamera sigurie (CCTV) për ambiente publike dhe mirëmbajtja e tyre.	**Programi AB141: Siguria publike dhe Mbrojtja civile**

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Bazuar në nenin 29 të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike, Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e mbrojtjes civile, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Në nenin 5 të ligjit Nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", përcaktohen qartë detyrimet në funksion të përcaktimeve ligjore, kërkohet marrja e masave shtesë per sigurinë në sheshe të hapura, parqe, kënde të lojërave, parkime, në mjedise të hapura apo të mbyllura, që kemi në administrim apo pronësi dhe që sipas vlerësimit të Policisë Bashkiake përbëjnë burim rreziku të shtuar për rendin dhe sigurinë publike.
Policia e Shtetit identifikon të gjitha subjektet që disponojnë dhe administrojnë sisteme të sigurisë, si kamera për regjistrim të pamjeve filmike, CCTV me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj apo përdorin pajisje elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli, reader, GPS etj.), me qëllim njoftimin dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e të dhënave.
Masat shtesë të sigurisë janë:

- Përdorimi i sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj;
- Përdorimi i pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli, reader, GPS etj.);
- Në varësi të vlerësimit të rrezikut dhe në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, lidhja e sinjalit të alarmit për bankat dhe objekte të rëndësishme shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, me sallat e komandimit/informacionit të Policisë së Shtetit;
- Përdorimii Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike (SHPSF).
- Niveli i masave shtesë të sigurisë dhe lloji i masës që duhet të përdorin subjektet, në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, përcaktohen me udhëzim tëministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
- Vendosjadhe përdorimi i masave shtesë të sigurisëshoqërohet me njoftimin për publikun.

Bashkia me nismën e saj, me burimet e veta financiare ka investuar për blerjen dhe instalimin e kamerave me rezulocion të lartë me qëllim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit të sigurisë dhe qetësisë publike në interes të bashkësisë.
Bashkëpunimi me drejtorinë vendore të Policisë së Qarkut Shkodër, Ministrinë e Brendshme është e domosdoshme. Mirembajtja e instrumentave të tillë për rritjen e kontrollit dhe monitorimit të sigurisë publike do të ndihmojë dhe mbështesë edhe punën e Drejtorisë Vendore të Policisë, institucioneve të tjera publike, bizneseve dhe familjeve në Shkodër. Do të garantojë më shumë siguri dhe rend për rininë dhe do të ndihmojë në reduktimin e kundravajtjeve dhe krimit.
Të jenëprioritet

- Kamera sigurie (CCTV) për ambjente publike dhe mirëmbajtja e tyre, vendosja e kamerave ose edhe rritja e masave monitoruese në rrugën drejt malësive të Dukagjinit, Cukalit për të mbikëqyrur prerjen dhe transportin e paligjshëm të pyjeve, aktivitete të tjera të paligjshme.
- Të forcohen masat monitoruese në sheshin, parkingjet e Shirokës, kjo zonë duhet të ketë përparësi në vendosjen e kamerave.
- Të shtohen kamerat monitoruese në kryqëzimin e rrugës "Bujar Bishanaku" me rrugën "Nazmi Kryeziu", me qëllim monitorim trafikut dhe hapësirave publike në këtë rrugë.
- Të shtohen kamerat monitoruese në kryqëzimin e rrugëve "Te Plepi", me qëllim monitorim trafikut dhe hapësirave publike në këtë rrugë.
- Të vendosen kamerat monitoruese në sheshin kryesor Velipojë si dhe përgjatë pedonales së plazhit, me qëllim monitorim hapësirave publike dhe rritjen e sigurisë për turistët.
- Të shqyrtohet mundësia, në bazë të vlerësimit të kostos financiare, për bashkërendimin e investimit në fibrat optike të rrjetit të kamerave të sigurisë për t'u integuar me sistemin e Policisë së Shtetit.

Të përfshihet përshkrimi dhe raportimi i punës të këshillit të sigurisë në këtë projekt.

ii. Synimi i projektit

- Mirëmbajtje e qendrueshmër e sistemit të vëzhgimit me kamera (CCTV) dhe rritja e numrit të tyre me qëllim mbikqyrjen e ambienteve publike, në të cilin mund të zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike, tregtare, sportive, kulturore, mjedise publike e private për shërbime, parkim automjetesh, me qëllim rritjen e sigurisë publike.
- Rritjen e sigurisë dhe qetësisë publike.
- Sigurimin e monitorimit dhe kontrollit më të mirë të territorit duke investuar në blerjen dhe instalimin e rreth 20 kamerave rezulocion të lartë me qëllim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit të sigurisë dhe qetësisë publike në interes të bashkësisë.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim
- Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime;
- Realizimi i procedurave të prokurimit;
- Njoftimi për publikun

b) Rezultatet që prisni

- Mbajtja e sistemit të kamerave në gjendje optimale në shërbim të rritjes së sigurisë publike;
- Rritja e sigurisë publike
- Rritja e kapaciteteve monitoruese të pikave të cilat sipas analizës së rriskut rezultojnë me fluks të shtuar të mundësive për ndodhi ose ngjarje që cënojnë rendin dhe sigurinë publike;
- Reduktim i kundravajtjeve administrative;
- Reduktim i veprave penale;

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Policia Bashkiake Policia e Shtetit	**Bashkia e Shkodrës**

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Mirëmbajtja e sistemit të kamera sigurie	**2,000**			**2,000**		
	Shuma 2027	**2,000**			**2,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Mirëmbajtja e sistemit të kamera sigurie	**2,000**			**2,000**		
	Shuma 2028	**2,000**			**2,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Mirëmbajtja e sistemit të kamera sigurie	**2,000**			**2,000**		
	Shuma 2029	**2,000**			**2,000**		

f) Periudha e zbatimit 2027-2029	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Policia bashkiake **Institucioni likuidues**:Bashkia Shkodër

Nr.7	**P.AB141.Q2.O1.A1.** Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. Burimet e veta	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Baza ligjore:139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave",ligji 45/2019 "Për mbrojtjen civile", shkresa nr.2634/2 datë13.12.2019 e Ministrisë së Mbrojtjes "Mbi zbatimin e dispozitave tëligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen civile.

Shërbimi për mirëmbajtjen emergjente të akseve të rrugëve ka pasur një rol të rëndësishëm në menaxhimin e kushteve të dimrit gjatë periudhës së reshjeve të dëborës, si në zonat malore, ashtu edhe në ato fushore. Nga operatori i kontraktuar janë realizuar masa të përshtatshme për të garantuar kalueshmërinë e akseve të rrugëve dhe për të përballuar izolimet e mundshme që mund të shkaktohen nga dëbora, veçanërisht në zonat malore.
Për të siguruar një nivel të lartë të gatishmërisë, janë bërë përgatitje përmes blerjeve të 80 ton kripë të zezë, e cila është përdorur për të mbajtur të hapura rrugët rurale dhe urbane dhe për të parandaluar formimin e ngricave. Kjo ka ndihmuar në rritjen e sigurisë për qytetarët që udhëtojnë gjatë periudhave të dimrit.

Po ashtu, për të përmirësuar menaxhimin e situatave emergjente në të ardhmen, është duke u realizuar një procedurë për marrëveshje kuadër, me objekt "Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të qytetit dhe të Njësive Administrative (zonat fushore)". Ky marrëveshje ka për qëllim përforcimin e gatishmërisë për mirëmbajtjen e akseve të rrugëve në zonat urbane dhe fushore, duke parashikuar masa të mëtejshme për të përballuar sfidat e mundshme që mund të krijohen nga kushtet klimatike të dimrit.

Këto përpjekje janë një pjesë e angazhimit për përmirësimin e sigurisë dhe menaxhimit të infrastrukturës rrugore, duke garantuar kalueshmërinë dhe mbrojtjen e qytetarëve gjatë dimrit.
-Vënie në shërbim i dy borëpastruese për hapje rruge, në zonat fushore.
Këto mjete të specializuara janë parashikuar të ndërhyjnë në rrugët e qytetit dhe të njësitë administrative fushore, për të bërë të mundur pastrimin e borës në mënyrë që të sigurohen kushtet e qarkullimit në një kohë sa më të shpejtë të njerëzve dhe mjeteve.
- Vënie në shërbimi një fadromë për punime hapje rruge në raste emergjencash, në zonat malore.
- Vënie në shërbim i dy eskavatorëve për punime hapje rruge në raste emergjencash, në zonat malore

Me këto 3 mjete janë parashikuar ndërhyrjet për hapjen e rrugëve në aksin Ura e Mesit-Prekal – Kir –Mali Shoshit –Breglumi- Ndërlysaj-Thethë, njësia administrative Postribë-Pult –Shosh-Shalë. Punimet e parashikuara janë zhbllokimi i rrugëve nga dëbora në të gjithë aksin si dhe hapjen e rrugëve dhe riparimin e pasojave nga rreshqitjet e materialeve si gurë, dhera etj.
Me këto masa i kemi paraprirë ndërhyrjeve në kohë për hapjen e rrugëve për të bërë të mundur zvogëlimin e kohës së izolimit për banorët e këtyre zonave.
Rruga Qafë Thore-Theth është në administrim të subjektit sipërmarrës të kontratës së shërbimit që karealizuar investimin me fonde të FSHZH-së.

Problemet e paraqitura:
- Pamjaftueshmëria e mjeteve për përballimin e situatave që krijohen nga emergjencat civile
- Nevoja për plotësim i strukturës së emergjencave civile sipas parashikimeve ligjore.
- Mungesa e kapaciteteve për përballimin e situatës në rast të përmbytjeve në Njësitë Administrative që preken nga përmbytjet.

ii. Synimi i projektit

Duke iu referuar
- Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile",

Synojmë:
- Sigurimi i një mbrojtjeje efektive dhe të qëndrueshme për qytetarët dhe asetet e Bashkisë Shkodër nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile.
- Krijimi dhe organizimi i një strukture të dedikuar për menaxhimin e emergjencave civile në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Angazhimi i vullnetarëve civilë si pjesë integrale e këtyre strukturave, duke kontribuar në reagimin e shpejtë dhe efektiv ndaj situatave emergjente
- Puna për të ulur rrezikun dhe ndikimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera, me qëllim realizimin e mbrojtjes civile në nivelin më të lartë të mundshëm.
- Sigurimi i informacionit të vazhdueshëm dhe të qartë për qytetarët në lidhje me rreziqet dhe aktivitete emergjente, për të mundësuar veprime parandaluese.
- Prioriteti është parandalimi i situatave që mund të rrezikojnë jetën dhe pronën e qytetarëve, bizneseve, pasurive kulturore, natyrore dhe aseteve të tjera administrative.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Vlerësimi i disponibilitetit të burimeve njerëzore për përfshirjen e tyre në planikimin dhe menaxhimin e EC.
- Mbledhja e të dhënave nga të gjitha kompanitë private për mjetet që perdoren nga ana e tyre dhe që mund të angazhohen në rast të EC.
- Masat paraprake për përballimin e situatave nga rreshjet.
- Përmirësimi i kapaciteteve teknike nëpërmjet realizimit të blerjes së mjeteve për përballimin situate të EC.
- Trajnim i stafit të strukturave të bashkisë.

- Mledhja e të dhënave për të gjithë personat, institucionet, ojf etj. që kanë rol në planikimin dhe menaxhimin e EC.
- Hartimi i skemës së lajmërimit.
- Grumbullimi i të gjithe dokumentacionit ekzistues për vlerësimin e riskut në territor.
- Përgatitja e hartave të rrezikut për territoret që mungojnë.
- Takime në çdo NJA, rajon, lagje me perfaqësues komuniteti e struktura për hartimin e planit të masave që merren në rast rreziku.
- Vendosja e elementeve të sigurisë në institucionet publike si: shkalla e emergjencës, fikëset e zjarrit , hidrantët,etj.
- Sistemimi i kanaleve shkarkuese që rrezikojne të sjellin gjendjen e EC.
- Sistemimi i rrugeve kryesore që mund të bllokohen nga dëbora.

Për vitin 2027 - 2029 shpenzimet parashikohen si më poshtë:

Llogaritja e fondit te mbrojtjes civile			
VITI	**2027**	**2028**	**2029**
Burimet e veta	**3,355,080**	**3,342,203**	**3,409,819**
Fondet tona 1 %	33,551	33,422	34,098
Fonde te planifikuara	**33,551**	**33,422**	34,098

b) Rezultatet që prisni

Bashkia Shkodër përballon në mënyrë optimale situatat e emergjencave civile (ka kontroll mbi territorin, ka plan emergjence masash, shërben duke iu përgjigjur nevojës emergjente)

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile	33,551				33,551	
Shuma 2027		**33,551**				**33,551**	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile	33,422				33,422	
Shuma 2028		**33,422**				**33,422**	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile	34,098				34,098	
Shuma 2029		**34,098**				**34,098**	

f) Periudha e zbatimit 2027 – 2029	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile ne Bashki **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr.8	**P.AB141.Q2.O1.A3.** Pajisje dhe veshje pune për emergjenca civile	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

- **Pajisje dhe veshje pune për emergjenca civile**

Drejtoria e Emergjencave Civile e Bashkisë Shkodër ka detyrën e reagimit dhe menaxhimit të situatave të emergjencës, duke kryer monitorim, mbikëqyrje dhe operacione në terren. Aktualisht, njësia operacionale përballet me mungesë të pajisjeve thelbësore dhe mjeteve bazike të sigurisë, të nevojshme për ndërhyrje të shpejtë dhe efektive në raste përmbytjesh, zjarresh, rrëshqitjesh dherash dhe emergjencave të tjera natyrore apo të krijuara nga faktori njerëzor.

Mospasja e një inventari të plotë të pajisjeve rrit rrezikun për personelin, ul efikasitetin operativ dhe dëmton cilësinë e ndërhyrjes. Për këtë arsye, është e domosdoshme furnizimi i sektorit me pajisje mbrojtëse, mjete ndriçimi, mjete pune, pajisje sinjalizuese dhe elemente të tjera të domosdoshme për operacione emergjente.

Lista e pajisjeve të nevojshme për përmirësimin e kapaciteteve operacionale përfshin:

Çadra për emergjenca, Kone sinjalizimi , Shirita sigurie, Pompa shpine kundër zjarrit, Metër lazer Bosch, ,Adesiva me numrin e emergjencave, dhe paisje te tjera te ngjashme.

Këto pajisje plotësojnë standardet minimale të nevojshme për ndërhyrje në terren, sigurojnë mbrojtje individuale dhe rrisin efikasitetin në operacionet e emergjencave.

ii. Synimi i projektit

Synimi kryesor i projektit është furnizimi i Drejtorisë së Emergjencave Civile me pajisjet dhe veshjet e nevojshme të punës, për garantimin e një niveli të lartë sigurie, gatishmërie dhe reagimi operacional.

Projekti ka për objektiv:

-Rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së stafit gjatë operacioneve;
-Përmirësimin e aftësisë së reagimit të shpejtë;
-Sigurimin e pajisjeve standarde për ndërhyrje në terren;
-Rritjen e profesionalizmit dhe efikasitetit të njësisë;
-Përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore për emergjencat civile.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Identifikimi i nevojave dhe hartimi i specifikimeve teknike të pajisjeve; Procedurat e prokurimit të pajisjeve dhe veshjeve të punës;
Marrja në dorëzim dhe regjistrimi në inventar i pajisjeve; Shpërndarja e pajisjeve tek stafi operacionale;
Trajnimi dhe instruktimi për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.

b) Rezultatete pritshme

- Sigurimi i një niveli të lartë mbrojtjeje dhe sigurisë për stafin e emergjencave.
- Rritje e efikasitetit dhe gatishmërisë së reagimit në situata emergjente.
- Pajisje të standardizuara dhe të përshtatshme për operacione të ndryshme në terren.
- Ulje e rreziqeve për dëmtime dhe aksidente gjatë ndërhyrjeve.
- Përmirësim i koordinimit dhe fleksibilitetit operativ të njësisë.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 4. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2027		Total (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1.	Pajisje dhe veshje pune për emergjenca	**500**			500		
TOTALI 2027		**500**			500		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2028		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Pajisje dhe veshje pune për emergjenca	**500**			500		
TOTALI 2028		**500**			500		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2029	Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale

A.1	Pajisje dhe veshje pune për emergjenca	**500**			500		
Totali 2029		**500**			500		

f) Periudha e zbatimit 2027 -2029	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr.9	**P.AB141.Q2.O1.A4.** Furnizim me karburant në funksion të emergjencave civile	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Baza ligjore:139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave",ligji 45/2019 "Për mbrojtjen civile", shkresa nr.2634/2 datë13.12.2019 e Ministrisë së Mbrojtjes "Mbi zbatimin e dispozitave tëligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen civile".

Në kuadër të thirrjes së shpallur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) për paraqitjen e projekteve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në fushën e Mbrojtjes Civile, Bashkia Shkodër synon të aplikojë me disa projekte për ndërtimin e urave të tipit "Bailey", të cilat do të realizohen në bashkëpunim me Repartin Ushtarak nr. 4040 (Batalioni i Xhenios).
Bazuar në praktikat e mëparshme, Bashkia do të marrë përsipër bashkëfinancimin e projekteve, përfshirë furnizimin me karburant të mjeteve të ushtrisë të angazhuara në këto operacione, si dhe ndërhyrje në raste të tjera emergjente sipas nevojave të Drejtorisë, që përfshijnë inspektim, mbikëqyrje dhe monitorim të infrastrukturës kritike dhe veprime të tjera mbështetëse në funksion të mbrojtjes civile.

i. Synimi i projektit

Duke iu referuar
- Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Synojmë:
- Sigurimi i një mbrojtjeje efektive dhe të qëndrueshme për qytetarët dhe asetet e Bashkisë Shkodër ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.
- Krijimi dhe organizimi i një strukture funksionale për menaxhimin e emergjencave civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Angazhimi i vullnetarëve civilë si pjesë e mekanizmave të reagimit në situata emergjente.
- Zvogëlimi i rrezikut dhe ndikimit të fatkeqësive përmes masave parandaluese dhe ndërhyrjeve të shpejta.
- Sigurimi i informimit të vazhdueshëm dhe të qartë për qytetarët në lidhje me rreziqet dhe veprimet që duhet të ndërmerren në raste emergjente.
- Parandalimi i situatave që mund të rrezikojnë jetën, pronën e qytetarëve, pasuritë kulturore, natyrore dhe asetet e tjera të Bashkisë.
- Përmirësimin e kapaciteteve të Bashkisë për inspektimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e infrastrukturës kritike, në mënyrë që të garantohet reagim i koordinuar dhe parandalim i situatave që mund të rrezikojnë jetën, pronën dhe pasuritë publike.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit
- Përmirësimin e kapaciteteve të Bashkisë për inspektimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e infrastrukturës kritike, në mënyrë që të garantohet reagim i koordinuar dhe parandalim i situatave që mund të rrezikojnë jetën, pronën dhe pasuritë publike.
- Zbatimi i ndërhyrjeve emergjente dhe operacioneve të kontrollit teknik, sipas kërkesave të Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, përfshirë inspektim, mbikëqyrje dhe monitorim të infrastrukturës rrugore dhe urave, me qëllim garantimin e funksionalitetit dhe sigurisë së tyre.
- Forcimi i infrastrukturës mbështetëse për banorët e zonave rurale, duke siguruar lëvizshmëri të qëndrueshme dhe reagim të shpejtë në raste emergjente.
- Krijimi i një rrjeti efikas të shërbimeve emergjente, që mund të veprojnë pa pengesa në të gjitha zonat e Bashkisë Shkodër, veçanërisht në ato me akses të vështirë..

b) Rezultatet që prisni

Bashkia Shkodër synon të përforcojë infrastrukturën dhe mbështetjen për banorët e zonave rurale.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Furnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile	**1,000**			1,000		
Shuma 2027		**1,000**			**1,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali	Ngakjo:				

		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Furnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile	**1,000**			1,000		
Shuma 2028		**1,000**			**1,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Ngakjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Furnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile	**1,000**			1,000		
Shuma 2029		**1,000**			**1,000**		
f) Periudha e zbatimit 2027 – 2029		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile ne Bashki **Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër					

Nr.10	**P.AB141.Q2.O1.A5** Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Baza ligjore:139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave" si dhe vecanerisht VKM 329, date 16.05.2012

- Është bërë vlerësimi i dëmeve nga specialistët e ngarkuar me urdhër të brendshëm dhe hartimi i preventivave për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore
- Është plotësuar dokumentacioni për dhënien e ndihmës se menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie

Për të gjitha rastet e zjarrit në banesa është kryer verifikimi e hartuar dokumentacioni, është dhënë ndihma e menjëhershme si dhe është bërë vlerësimi i dëmeve ekonomike dhe dhënia e vlerave financiare(dëm ndërtimor në banesa + orendi)

ii. Synimi i projektit

Duke iu referuar

- Shkresës së Ministrisë së Brendshme nr. 7007, datë 20.10.2016 "Për planifikimin e fondeve për mbrojtjen civile dhe për hartimin e dokumentacionit për familjet,banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësit e ndryshme "
- Ligjit nr. 45/2019 "Për Mrojtjen Civile" i përditësuar ,
- VKM 329 datë 16.05.2012 "Per kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimine dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerzore"
- VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimimin e procedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të dedikuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"

Është parashikuar mbulimi i shpenzimeve për menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie Synojmë:

- Dhënien e ndihmës së menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie
- Dhënien e dëmit ekonomik (ndërtimor + orendi) për familjet me raste fatkeqësie.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Ndërtimi i bazës së të dhënave për rastet e paraqitura për t'u trajtuar me ndihmë të menjëhershme nga Bashkia Shkodër.
2. Ndërtimi i bazës së të dhënave për rastet e paraqitura për t'u trajtuar me dëmin ekonomik (preventive ndërtimore + orendi) për trajtim të mëtejshëm financiar.
3. Hartimi dhe plotësimi i dokumentacionit për t'iu drejtuar Këshillit Bashkiak për shqyrtim dhe për të marrë vendime për dhënie ndihme të menjëhershme si dhe vlerësimi i dëmeve ekonomike dhe dhënia e vlerave financiare

b) Rezultatet që prisni

Bashkia Shkodër përballon situatat për familjet me raste fatkeqësie sipas mundësive dhe bazuar në ligj.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Bashkia Shkodër; Kryeministria; Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, etj. AKMC; Prefektura Shkodër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferte	Kapitale
A.1	Shpërblim për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore etj	**2,340**				**2,340**	
	Shuma 2027	**2,340**				**2,340**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferte	Kapitale
A.1	Shpërblim për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore etj	**2,340**				**2,340**	
	Shuma 2028	**2,340**				**2,340**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferte	Kapitale
A.1	Shpërblim për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore etj	**2,340**				**2,340**	
	Shuma 2029	**2,340**				**2,340**	

f) Periudha e zbatimit 2027 – 2029	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile ne Bashki **Institucion likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr.11	**P.AB141.Q2.O1.A6.** Paga për sektorin e emergjencave të Bashkisë	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

- **Paga dhe shtesat mbi paga**

Shpenzimet e personelit janë planifikuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, mbi bazën e numrit të punonjësve, strukturës dhe organikës së miratuar, niveleve të pagave sipas klasave përkatëse, si dhe shtesave mbi pagë.

Për përllogaritjen e fondit të pagave është marrë në konsideratë VKM nr. 776, datë 19.12.2025, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", si dhe VKM nr. 103, datë 11.02.2026, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar".

Gjithashtu, në planifikimin e shpenzimeve të personelit është zbatuar VKB nr. 13, datë 27.02.2026, "Për ndryshim në VKB nr. 54, datë 30.09.2024, "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"", duke reflektuar ndryshimet e miratuara në nivelet e pagave.

Në këtë kuadër, fondi i shpenzimeve të personelit është përllogaritur në përputhje me numrin e punonjësve dhe nivelet përkatëse të pagave e shtesave mbi pagë, si dhe detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke respektuar kufijtë dhe kriteret e përcaktuara në aktet në fuqi.

Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore:

Në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi.

ii. Synimi i projektit

Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.
Analizë sipas ngarkesës, sipas funksioneve, ligjeve sektoriale për zbatim dhe akteve nënligjore për rolin e secilës drejtori dhe sektor.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi i shpenzimeve
1. Paga,
2. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

b) Rezultatete pritshme

- Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.
- Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 6. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2027		Total (000 lekë)	Nga kjo: Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	**10,958**	**10,958**				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	**1,743**		**1,743**			
TOTALI 2027		**12,701**	**10,958**	**1,743**			

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2028		Total (mijë lekë)	Nga kjo: Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**10,958**	**10,958**				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**1,743**		**1,743**			
TOTALI 2028		**12,701**	**10,958**	**1,743**			

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2029		Total (mijë lekë)	Nga kjo: Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**10,958**	**10,958**				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**1,743**		**1,743**			
Totali 2029		**12,701**	**10,958**	**1,743**			

f) Periudha e zbatimit	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
2027 -2029	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse **Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr.12	P.AB141.Q.2O.1.A.7 Projekti Territory	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit "SA-0300305/TERRITORY" në kuadër të Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA III) Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021/2027. Qëllimi kryesor i projektit TERRITORY është të forcojë kapacitetet për menaxhimin e fatkeqësive nëpërmjet zbatimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe inovativ të bazuar në dronë dhe inteligjencë artificiale.

Projekti Territori synon të përmirësojë menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në rajonin e Adriatikut Jugor (Itali, Shqipëri, Mal i Zi) përmes teknologjisë inovative dhe inteligjencës artificiale (IA). Rajonet përfituese karakterizohen nga një diversitet i lartë gjeografik dhe një ndjeshmëri të shtuar ndaj rreziqeve natyrore të përkeqësuara nga ndryshimet klimatike, si përmbytjet, zjarret në natyrë dhe emergjencat e tjera mjedisore. Këto rreziqe përbëjnë një kërcënim në rritje për jetën, infrastrukturën dhe ekosistemet lokale, prandaj kerkojnë zgjidhje të reja për parandalim, monitorim dhe reagim efektiv. Projekti Territori do të vlerësojë rolin e teknologjive UAS (Sisteme Ajrore Pa Pilot) dhe Inteligjencës Artificiale (IA) në menaxhimin e rreziqeve mjedisore, të cilat përbëjnë sfida të përbashkëta për partnerët në Itali, Shqipëri dhe Mal të Zi. Duke kombinuar Sistemet Ajrore Pa Pilot (UAS) me Inteligjencën Artificiale (IA), projekti mundëson vendimmarrje më të shpejtë dhe më smart në raste emergjencash, duke përdorur përpunimin dhe analizën e të dhënave në kohë reale. Kjo qasje lejon përgjigje më efikase dhe të sakta, veçanërisht në zona të rrezikshme ose të vështira për t'u aksesuar.Përtej aspektit teknologjik, Territori do të kontribuojë në ndërtimin e një rrjeti të qëndrueshëm të profesionistëve të menaxhimit të fatkeqësive, të përfshirë në nivel lokal dhe rajonal. Ky rrjet do të lehtësojë përafrimin e strategjive për menaxhimin e rreziqeve përtej kufijve kombëtarë, duke siguruar bashkëpunim të vazhdueshëm, ndarje njohurish dhe përmirësim të qëndrueshëm të përgatitjes dhe reagimit ndaj fatkeqësive.

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 30 muaj nga data e nënshkrimit nga të gjithë partnerët. Vlera e buxhetit për Bashkinë Shkodër është 112,786.94 € euro, e konvertuar në lekë në shumën 10,959,507 lekë. Vlera do të transferohet për llogari të Bashkisë Shkodër sipas Udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare". Granti do të mbulojë 85% të vlerës totale të projektit, në shumën prej 95,868.89 euro (9,315,581 lekë), ndërsa 15% e mbetur përbën bashkëfinancimin nga Bashkia Shkodër, në shumën prej 16,918.04 euro (1,643,926 lekë). Konvertimi në lekë është bërë sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, 97.17 EUR, në datën 20.08.2025, datë e cila përkon me nënshkrimin e Marrëveshjes së Partneritetit nga Bashkia Shkodër. Vlera e TVSH-së është shpenzim që nuk mbulohet me fondet e Bashkimit Evropian. Kjo vlerë do të financohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër me fondet e veta.

ii. Synimi i projektit

Qëllimi kryesor i projektit Territory është të forcojë kapacitetet për menaxhimin e fatkeqësive nëpërmjet zbatimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe inovativ të bazuar në dronë dhe inteligjencë artificiale.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Vlerësimi i nevojave të vendeve partnere në Puglia dhe Molise në Itali, Shqipëri dhe Mal të Zi.
2. Organizimi i 4 puntorive me autoritetet lokale, agjencitë, eksperte të fushës.
3. Forcimi i kapaciteteve të partnerëve të projektit në menaxhimin e fatkeqësive përmes vlerësimit të përgjithshëm të burimeve dhe proceseve dhe hartimit të zgjidhjeve smart.
4. Përgatitja për trajnimin e shërbimeve të dronëve.
5. Transferimi i njohurive.
6. Hartimi i një skenari pilot, arkitektura e sistemit dhe shërbimit.
7. Implementimi dhe vendosja e sistemit të Platformës së Droneve Territori.
8. Realizimi dhe shfrytëzimi i pilotit.
9. Blerja e dronëve dhe lidhja e tyre me platfomën e Territori.

Rezultatet:

- ✓ Zhvillimi dhe testimi i zgjidhjeve të bazuara në dronë për situata të ndryshme fatkeqësish.
- ✓ Integrimi i teknologjisë me strategjitë ekzistuese të menaxhimit të emergjencave.
- ✓ Zhvillimi i planeve të veprimit për përdorimin e dronëve në përgatitje dhe reagim ndaj fatkeqësive.
- ✓ Trajnime për autoritetet lokale dhe agjencitë përgjegjëse, për të siguruar përdorim efektiv të teknologjive të reja.
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndarja e njohurive mes tre vendeve për përballimin e rreziqeve të përbashkëta.

c)Aktorët e mundshëm	**d)Kontributet e mundshme në projekt**
✓ Bashkia Shkodër ✓ Drejtoria e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi MZSH ✓ Partnerët e projektit Territori	Bashkia Shkodër Programi IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor)"

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime **(bashkëfinancim)**	**640**	548	92			
A.2	Paga dhe sigurime (donatori)	**2,514**	2,154	360			
A.3	Shpenzime për udhëtim dhe akomodim (donatori)	**162**			162		
A.4	Blerje dron për kontroll permbytjesh, zjarresh (donatori)	**2,332**					2,332
A.5	Organizimi i një workshop në Shkodër (donatori)	**212**			212		

A.5.1	Organizimi i një workshop **(fondet e bashkisë)**	**101**			101		
A.6	Përmbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit **(tvsh fondet e**	**562**			95		467

	Shuma 2027	**6,523**	**2,702**	**452**	**570**		**2,798**
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime (donatori)	**629**	539	90			
	Shuma 2028	**629**	**539**	**90**			
f) Periudha e zbatimit 2027,2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Emergjencave Civile **Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër					

Nr. 13	**P.AB141.Q2.O1.A8.** Plotësimi dhe çertifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 29, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike" përcakton se:

1. Bashkia ka përgjegjësi për mbrojtjen civile në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse sipas ligjit;
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse sipas ligjit.

Aktualisht, një pjesë e objekteve të Bashkisë Shkodër, të përdorura për realizimin e funksioneve të saj, nuk janë të pajisura me aktet për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH), si dhe nuk disponojnë mjetet e detyrueshme sipas ligjit për Mbrojtjen nga Zjarri (MKZ). Kjo gjendje rrezikon rëndë sigurinë e këtyre objekteve dhe, në veçanti, jetën e qytetarëve.Sipas Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Neni 3, germa 2, "Çertifikata e mbrojtjes nga zjarri" është akt administrativ i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, i cili vërteton përmbushjen e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.Gjithashtu, sipas Kreut IX, Neni 39, pika 1–4, çdo objekt duhet të ketë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Urdhëri i Ministrit Nr. 425, datë 24.07.2015, përcakton dokumentacionin teknik dhe grafik që duhet paraqitur për marrjen e çertifikatës së mbrojtjes nga zjarri. Ndërkohë, VKM Nr. 285, datë 27.06.2002, pika 3.1 dhe 3.2, përcakton tarifat për çertifikatat e zjarrit dhe rinovimin e tyre vjetor. Duke marrë parasysh këto dispozita ligjore, lind detyrimi për plotësimin e dokumentacionit ligjor-teknik dhe sigurimin e çertifikatës së MZSH
për të gjitha objektet në vartësi të Bashkisë, duke përfshirë në mënyrë të veçantë edhe godinën kryesore të Bashkisë.

ii. Synimi i projektit

2027
Evidentimi i nevojave për blerje dhe rimbushje fikëse zjarri. Pajisje me fiksëve automatike për objektet e tjera. Rimbushja e bombolave të fikseve automatike të zjarrit. Blerja e fiksëve automatike për objekte të tjera
Rimbushje bombulave të fikseve automatike të zjarrit , bombulave të fikseve automatike të zjarrit për rimbushje gjendje pranë MZSH-se, në godinat e Bashkisë Shkodër
2028
Evidentimi i nevojave për blerje dhe rimbushje fikëse zjarri. Pajisje me fiksëve automatike për objektet e tjera. Rimbushja e bombolave të fikseve automatike të zjarrit. Blerja e fiksëve automatike për objekte të tjera
Rimbushje bombulave të fikseve automatike të zjarrit , bombulave të fikseve automatike të zjarrit për rimbushje gjendje pranë MZSH-se, në godinat e Bashkisë Shkodër
2029
Evidentimi i nevojave për blerje dhe rimbushje fikëse zjarri. Pajisje me fiksëve automatike për objektet e tjera. Rimbushja e bombolave të fikseve automatike të zjarrit. Blerja e fiksëve automatike për objekte të tjera
Rimbushje bombulave të fikseve automatike të zjarrit, bombulave të fikseve automatike të zjarrit për rimbushje gjendje pranë MZSH-se, dhe godinat e Bashkisë Shkodër

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Blerja dhe rimbushja e fikseve të zjarrit në godinat në administrim të Bashkisë Shkodër
2. Prokurimi i të gjitha mjeteve MKZ për të gjitha objektet në administrim të Bashkisë.

b) Rezultatet që prisni

Rritje e sigurisë publike në objektet ku realizon kompetencat Bashkia Shkodër. Objekte të pajisura me mjetet fikëse të zjarrit dhe rimbushja e tyre.

c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerja dhe rimbushje e fikseve të zjarrit.	**1,000**			1,000		
	Shuma 2027	**1,000**			**1,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerja dhe rimbushje e fikseve të zjarrit.	**1,000**			1,000		
	Shuma 2028	**1,000**			**1,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijelekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerja dhe rimbushje e fikseve të zjarrit.	**1,000**			1,000		
	Shuma 2029	**1,000**			**1,000**		

f) Periudha e zbatimit 2027 – 2029	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile në Bashki/ MZSH **Institucion likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr. 14	**P.AB141.Q2.O2.A1.** Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë.	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 29, i cili përcakton "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", Bashkia ka përgjegjësi për:

1. Mbrojtjen civile në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse sipas ligjit.

Aktualisht, pjesa më e madhe e objekteve të Bashkisë Shkodër nuk janë të pajisura me aktet për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH), si dhe nuk disponojnë mjetet e detyrueshme sipas ligjit për Mbrojtjen nga Zjarri (MKZ). Kjo gjendje rrezikon rëndë sigurinë e këtyre objekteve dhe, në veçanti, jetën e qytetarëve.

Sipas Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Neni 3, germa 2, "Çertifikata e mbrojtjes nga zjarri" është akt administrativ i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, i cili vërteton përmbushjen e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorisë së objektit.

Gjithashtu, sipas Kreut IX, Neni 39, pika 1-4, çdo objekt është i detyruar të ketë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Urdhëri i Ministrit Nr. 425, datë 24.07.2015, përcakton dokumentacionin teknik dhe grafik që duhet të paraqitet për marrjen e çertifikatës së mbrojtjes nga zjarri.

Ndërkohë, VKM Nr. 285, datë 27.06.2002, pika 3.1 dhe 3.2, përcakton tarifat për çertifikatat e zjarrit dhe rinovimin e tyre vjetor.

Duke marrë parasysh të gjithë këto dispozita ligjore, lind detyrimi i Bashkisë për plotësimin e dokumentacionit ligjor-teknik dhe sigurimin e çertifikatës së MZSH për të gjitha objektet në vartësi të saj, duke përfshirë edhe godinën kryesore të Bashkisë.

ii. Synimi i projektit

Synimet për 2027, 2028, 2029

- Kryerja e kontrollit sistematik vjetor dhe çertifikimi për MZSH i objekteve të Bashkisë sipas prioriteteve.
- Rifreskimi i akteve teknike për MZSH.
- Kryerja e kontrollit sistematik vjetor për çertifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë. Realizimi i projekteve per mbrojtjen kundra zjarrit për godinat e Bashkisë Shkodër.
- Realizmi i projekteve teknike për masat e MZSH

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Kontrolli dhe pajisja e të gjitha objekteve me çertifikatën për MKZ.
- Prokurimi i të gjitha mjeteve MKZ për të gjitha objektet në administrim të Bashkisë.

b) Rezultatet që prisni

Rritje e sigurisë publike në objektet ku realizon kompetencat Bashkia Shkodër.(Objekte të kolauduara për MKZ. Objekte të pajisura me grupin e mjeteve për MKZ).

c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.	**1,000**					1,000
	Shuma 2027	**1,000**					**1,000**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.	**1,000**					1,000
	Shuma 2028	**1,000**					**1,000**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.	**1,000**					1,000
	Shuma 2029	**1,000**					**1,000**

f) Periudha e zbatimit	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
2027-2029	Personeli i Drejtorisë së Emergjencave Civile ne Bashki/ MZSH **Institucion likuidues:** Bashkia Shkodër

Nr. 15	**P.AB141.Q2.O2.A2.** Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	**Programi AB141:** Siguria publike dhe Mbrojtja civile

a) Përshkrimi I shkurtër I projektit:

i. Situata

Në ligjin Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", Neni 29, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", pika 2, parashikon "*Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së* përcaktuar me ligj" sipas këtij ligji, ky funksion i kaloi Bashkisë së Shkodrës

Që me datë 19.01.2016 ,për realizimin e shërbimit te zjarrfikësve,përvec strukturës së brendshme të Bashkisë së Shkodrës, që ndjek politikat vendore për këtë veprimtari, do të funksionojë edhe Institucioni i varësisë "Drejtoria e emergjencave civile, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, Institucion i cili me Urdhër të kryetarit të Bashkisë Shkodër, datë 19.06. 2017,ristrukturohet me se miri ,si "Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi". Numri i punonjësve në këtë institucion është 55 punonjës.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në vijim shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut (LIGJ Nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, neni 2)

Po sipas këtij ligji, në Nenin 7, Organizimi i strukturës së shërbimit, pikat 3. Drejtoria ose sektori i shërbimit të MZSHsë në nivel vendor është në varësi të kryetarit të bashkisë. Ajo përfaqëson strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion.

Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të drejtorit te MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë.Ne propocion me numer popullsie mbi 200 mije banore,dhe 55 punonjes aktual te stacionit ,kemi raportin 1 punonjes per 43921. Dhe me plotesimin e numrit duhet te ngrihen dhe 2 stacione te tjera Zjarrfiksesh ,njeri ne zonen e NenShkodres(Berdice) dhe tjetri ne zonen e MbiShkodres (Njesia administrative Mes) ,me efektimin e plotesuar,ne menyre qe te jemi sa me pare qytetarëve.

Sektoi i Finances dhe shërbimeve mbështetese gjatë vitti 2020 u paisjen me pajisje TIK. Në Nenin 9, Kryetari i bashkisë ka këto përgjegjësi:

a) merr masa për ngritjen dhe kompletimin me mjete e pajisje të stacioneve për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, të shërbimit të MZSH-së në territorin e bashkisë, sipas standardeve e normave në fuqi;

b) planifikon fondet e shërbimit të MZSH-së, nga buxheti i bashkisë, për çdo vit.

Ne llogarine Transferime korente trajtohen disa punonjes, të cilët në zbatim të VKM 499 date 13.08.1998i ndryshuar me VKM 633 date 28.10.1998,përfitojne shperblim per perballimin e ngarkeses familjare mbi 3 femije. Në këtë llogari trajtohet edhe një punonjës sipas Neni 12 Shpërblimi i menjëhershëm dhe pagesa kalimtare 1. Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm i Forcave të Armatosura, i Policisë së Shtetit, i Gardës së Republikës, i SHISH-it, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të cilët, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxirren në rezervë apo lirim, marrin një shpërblim të menjëhershëm, në masën e dy pagave referuese mujore dhe pas këtij fillon trajtimi financiar me pagesë kalimtare. 2. Pagesë kalimtare jepet kur përfituesi ka jo më pak se 3 muaj shërbim. Pagesa kalimtare llogaritet në masën 50 për qind të pagës referuese mujore dhe fillon në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në rezervë apo lirim. 3. Trajtimi financiar me shpërblimin e menjëhershëm dhe me pagesë kalimtare, për të dyja llojet e përfitimeve së bashku, zgjat për aq muaj sa përfituesi ka vjetërsi shërbimi, por jo më shumë se 24 muaj. 4. Personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk përfitojnë shpërblim të menjëhershëm dhe pagesë kalimtare, në rastet kur: a) kryejnë vepra penale ose shkelje, që dënohen me masën disiplinore përjashtim nga Forcat e Armatosura, nga Policia e Shtetit, Garda e Republikës, SHISH-i, Policia e Burgjeve; b) largohen me kërkesën e vet për të filluar një veprimtari tjetër ekonomike ose për t'u punësuar në një sektor tjetër; c) dërgohen me një detyrë shtetërore më të lartë ose paralele, me pagë mujore jo më të vogël se paga që merrnin.

5. Në rastet kur përfituesi punësohet, mund të përfitojë pagesë kalimtare për aq kohë sa është përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, por deri në atë masë, sa paga e re plus pagesën kalimtare të mos e kalojnë pagën referuese mujore, në bazë të së cilës është llogaritur pagesa kalimtare.

Sfidat dhe përmirësimet e kërkuara në vijëmësi:

- Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi eshte funksion i deleguar nga qeveria qe në 1 janar 2016 dhe vepron në bazë të VENDIM Nr.520,datë 25.7.2019 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

- Strukturat e MZSH Shkodër financohen nga Transferta Specifike qeveritare per kete qellim. Bashkia Shkoder prej me se tre vitesh financon nga te ardhurat e veta buxhet shtese (dhe eshte nder te vetme tBashki ne Shqiperiqe e ben kete) per financimin per paga te pambuluara, shpenzime operative te pambuluara, Investime ne mjete dhe godina, Blerje pajisje operacionale. Situata krahasuar me ate kur ky sherbim eshte marre ne dorezim ka ndryshuar shume, qofte ne saje te mbeshtetjes, por edhe organizimit me te mire. Trupa jone e MNZ eshte nder me te mirat dhe te sterviturat ne programe nderkombetare ne Shëqiperi.

- Bashkia Shkoder, MNZ sherben edhe ne ndihme te nejsive te tjera vendore. Keshtu MNZ sherben sa here eshte e nevojshme ne Bashkine e Vaut te Dejes, Malesise se Madhe, Pukes, Fushe- Arrez-it, Lacit, Lezhes etj. Per sherbimin e kryer MNZSH, nuk Paguhet. Eshte e domosdoshme qe te vijohet insistimi per rishikimin e Vendimit te Keshillit Ministave per shperblimin per punen e kryer, ne menyre qe MNZ te paguhet per detyrimet qe jane te pa permbushura nga ana e qeverise. Gjithsesi MNZ Shkoder dhe Bashkia Shkoder do te mbeshtesin ne vijimsi me punen e tyre aty ku eshte nevoja ne raste emergjence dhe rreziku.

- Standart iligjor sipas ligjit Nr. 152 / 2015 "Për shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi" përcakton se njësia e shpëtimit duhet të ketë 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë. Për rrjedhojë bashkia Shkodër duhet të ketë të paktën 100 punonjës shpetimi. Kjo structure eshte e pamundur te mbulohet nga transferta specifike e percaktuar me ligj per financimin e sherbimit. Ne keto kushte Bashkia Shkoder dhe MNZ do te vijoje punen per edukimin dhe sensibilizimin e te rinjve, nxenes dhe studente ne shkolla dhe universitete per perfshirjen ne grupet vullnetare per te rritur kapacitetin aktual te sherbimit, te ndihmes ne rast nevoje perballimi me emergjencen.

ii. Synimi I projektit

- Forcimi i institucionit të MZSH
- Shërbim më i mirë dhe eficient i MZSH si rezultat i rritjes së stafit dhe organizimit më të mirë të ndarjes së funksioneve.
- Trajnime të stafit
- Shërbim më i mirë dhe eficient i MZSH si rezultat i rritjes së vazhdueshme të stafit dhe organizimit më të mirë të ndarjes së funksioneve.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2027, parashikohet në buxhetin e bashkisë për t'u shpenzuar për këtë funksion (paga, sigurime dhe shpenzime operative).
2. Procedura përgatitore

- Hartimi i kalendarëve të gadishmërisë dhe grupeve
- Hartimi i procedurave për kryerjen e shpenzimeve

3. Raportet e gadishmërisë dhe të ndërhyrjeve në rastet e emergjencave
4. Blerje pajisje uniforma per punonjesit zjarrfikes
5. Rikonstruksioni dyshemeve te garazhdeve dhe hidroizolimi i tyre

b) Rezultatet që prisni

- Rritja e sigurisë së jetës dhe të pronës së qytetarëve
- Minimizimi i dëmeve që mund të shkatohen nga zjarri apo emergjencat e tjera
- Funksionim sa me mire istrukturës
- Kryerje sipas kërkesave i shërbimit.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni që ndjek shpenzimin:Drejtoria e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	**64,179**	64,179				
A.2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	**10,207**		10,207			
A.3	Kancelari	**50**			50		
A.4	Materiale për pastrim,dizifek.,ngrohje dhe ndriçim	**82**			82		
A.5	Blerje dokumentacion	**50**			50		
A.6	Karburant	**2,000**			2,000		
A.7	Shërbime mirëmbajtje për automjetete e zjarrfikseve	**1,200**			1,200		
A.8	Rregjistrim,kolaudim,targa,TAKSA.	**450**			450		
A.9	Siguracion automjetesh	**400**			400		
A.10	Shpenzime udhëtim e dieta	**50**			50		
A.11	Pagesë energji elektrike	**650**			650		
A.12	Pagesë ujësjellësi	**160**			160		
A.13	Pagesë shërbime telefonike	**80**			80		
A.14	Shpenzime për mirëmbajtje paisje zyre etj	**100**			100		
A.15	Materiale dhe shërbime operative për MNZSH	**800**			800		
A.16	Pagesë primi sigurimi jete,për punonjësit e MZSH	**1,100**			1100		
	Shuma 2027	**81,558**	**64,179**	**10,207**	**7,172**		

		Totali	Nga kjo:				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga e sigurime	**74,386**	64,179	10,207			
A.2	Shpenzime operative	**7,172**			7,172		
	Shuma 2028	**81,558**	64,179	10,207	7,172	0	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Paga e sigurime	**74,386**	64,179	10,207			

A.2	Shpenzime operative	**7,172**			7,172		
	Shuma 2029	**81,558**	64,179	10,207	7,172	**0**	

Periudha e zbatimit Janar 2027 - Dhjetor 2029	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturerës, Sektori i planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës, Drejtoria e MZSH. **Institucion likuidues:** Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit